



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, mbajtur më 19.01.2023, duke filluar në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli-Mustafa, kryesuese, Ramadan Salihu, Gyltene Retkoceri dhe Jeton Canhasi.

Munguan: Mehreme Llumnica, Ermira Shabani dhe Armend Ademi.

Në mbledhje ishin të pranishme edhe: Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli, kryesuese e komitetit me këtë

REND TË DITËS:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 2. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara;**
- 3. Monitorimi i Planit të Veprimit;**
- 4. Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Pika e dytë dhe e tretë

Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të kufizuara dhe

Monitorimi i Planit të Veprimit

Fatime Demolli, kryesuese tha se sa i përket këtij Raporti që e ka përgatitur z. Ramadani unë isha fokusuar tek rekomandimet që dalin nga ky raport, meqenëse e kemi edhe Premtimën këtu

me pa se kush është përgjegjës për zbatimin e këtyre rekomandimeve, duke u bazuar në konkretizimin e detyrave të komitetit, a ka akt administrativ, udhëzim administrativ që e specifikon komitetin. Përveç udhëzimit administrativ kush është përgjegjës me i përcaktuar zëvendësimin e anëtarëve apo me vendos ndonjë kriter në rast të mungesës së tri apo më shumë anëtarëve të komitetit ata a zëvendësohen nga jashtë apo të jetë ndonjë rregull apo nen kush i zëvendëson. Pika e fundit që thotë mos me u kufizuar mbledhjet e komitetit por ato me u mbajt si e parashohin anëtarët.

Premtime Preniqi, dha sqarime duke thënë se sa i përket zbatimit të këtij plani, ne si komitet duhet me bërë një monitorim të planit, së pari mu takuar me kryetarin apo nënkryetarin, me biseduar lidhur me një grup qysh po mendojnë me vendim apo ju si komitet me bërë këtë monitorimin por me një vendim të ri që mandej me filluar me bërë monitorimin.

Sa i përket pikës së dytë konkretizohen detyrat efektive të komitetit, detyrat e komitetit me shpalljen e konkursit janë paraqitur edhe detyrat e komitetit.

Sa i përket pika për me u zëvendësuar anëtarët që mungojnë gjatë mbledhjes ndoshta kishte qenë mirë me u konsultuar me Zyrën ligjore.

Sa i përket pikës mos të kufizohemi në mbajtjen e mbledhjeve edhe në Vendim, shkruan që mbledhjet e komitetit janë 6 të obligueshme dhe që paguhen, ndërsa sipas nevojës komiteti mundet me mbajtur edhe tjera por këto nuk paguhen.

Fatime Demolli, kryesuese pyeti kush e bënë një akt administrativ për komitete në kuadër të Komunës.

Ramadan Salihu, dha sqarime duke shtuar se, unë e kam konsultuar edhe vendimin që e kemi marrë atë të parin dhe të dytin edhe konkursin por ai nuk po i specifikon detyrat, se dallojnë komitetet tjera se ne jemi specifik si kategori ashtu edhe komiteti i specifikuar se ne kemi të bëjmë zakonisht me të drejta edhe monitorimi po bëhet për të drejtat e PAK-ra, që në një farë forme jemi si një zyrtar që i shikon këto se çka ka mundësi në këtë Komunë me u bërë dhe çka po bëhet për PAK-ra.

Unë e kam shkruar më shumë në formën përshkuese këtë raport, të kjo pika e parë të rekomandimet është të zbatohet ligjshmëria dhe pikat nga plani i veprimit, të zbatohet në tërësi. E kemi shkruar draft këtë për shkak se u mungon përmbajtja por kam menduar që bëhet ndonjë debat më i gjatë e vendosim edhe ndonjë pikë tjetër e pastaj ndërron formati, nëse ju mendoni me e ndërruar këtë metodologjinë e përshkrimit, kështu që jeni të lirë të jepni prapë mendime e sugjerime që nëse diçka me larguar e largojmë, kurse këtë formën përfundimtare duhet me e vendosë përmbajtjen e me i ndarë këto nëpër faqe të reja.

Premtime Preniqi, tha se unë e kisha propozuar ndoshta me qenë kjo fillimi hyrja e raportit komplet një farë përshkrimi rreth asaj çfarë është punuar, çfarë nuk është punuar, sepse disa gjëra kanë lëvizur prej vendit mirëpo ato janë punë në vete, ndërsa këto procesverbalet të cilat janë paraqitur këto ndoshta me iu shtuar si aneks shtesë, për me i bindur.

Fatime Demolli, tha se si po e mendoni Premtime, a me shkuar kjo kështu vetëm nëse rregullohet me atë draftin tjetër që po e potencon z. Ramadani, apo me dalë me monitoruar në terren planin e veprimit e pastaj me dërguar tek asamblistët, se nëse dërgohet kjo kështu nuk e dimë sa ka ndryshime. Kjo në fakte ka ndryshime është bërë vendimi prej Drejtorisë Komunale të Arsimit, me iu paguar transportin edhe fëmijëve në çerdhe, vendim i cili ka qenë më herët vetëm për nxënësit në shkolla, Drejtoria e Arsimit, tash e ka bërë edhe për çerdhe. Drejtoria e Arsimit i ka punësuar 25 psikologë, ka punësuar asistentë d.m.th. ka lëvizshmëri.

Gyltene Retkoceri, tha se janë punësuar tre persona me nevoja të veçanta.

Fatime Demolli, ceku çështjen e "Prishtina Parking", se nuk e ka atë informatë a është finalizuar rregullorja së pari si komitet se a është publikuar.

Unë mendoi me u konsultuar me dikë paraprakisht për të na mbështetur me dal në terren me parë zbatimin e planit të veprimit, d.m.th me bërë një monitorim dhe pasi të kthehemi prej terrenit të monitorimit atëherë me e përgatitë një draft dhe me e dërguar në asamble.

Ramadan Salihu, tha se çështja e pranimit të drejtorëve në takim dhe mos pranimi i komitetit, ky është problem, është problem në parim, ne gjithmonë po bëjmë kërkesë të shkojmë tek arsimit, tek burimet njerëzore, apo edhe tek kryetari e nënkryetari, nëse kanë dëshirë të na pranojnë mirë nëse nuk na pranojnë nuk është problem, p.sh. kryesuesja së paku pesë herë e ka thirrur drejtoreshën e Arsimit Besianë Musmurati dhe ajo nuk ju ka përgjigj ftesës, kjo përveç që është papërgjegjësi por është edhe injorim i një kategorie të caktuar të njerëzve.

Gyltene Retkoceri, tha se ndoshta është mirë me shikuar me i gjet disa mekanizma që çështjen e PAK-ra, në Komunën e Prishtinës me qenë një grup punues që merr masa më serioze ndaj Komunës d.m.th mos me pas mundësi drejtoresha e Arsimit me iu refuzuar pesë herë por kur ju i shënoni email maksimumi herën e dytë me iu pranuar etj.

Premtime Preniqi, tha se gjithmonë e rëndësishme është të takohemi me Kryetarin e Komunës, ose me drejtorët, mirëpo ndonjëherë në qoftë edhe zyrtari punën e kryen ajo është me rendësi se po kryhet punë.p.sh. neve na ka pritur drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Iliriku dhe kemi kaluar me të vërtetë shumë mirë, mirëpo të gjitha ato që i ka premtuar Iliriku janë akoma të pa miratuara.

Ramadan Salihu, tha se ajo çfarë unë po kërkojë, të ketë një akt administrativ i cili e përcakton këtë që kur t'i ftoni njerëzit me pas një dinjitet gjatë komunikimit d.m.th, drejtorët duhet të jenë të obligueshëm, jo me të mësuar t'i dërgoni ftesë këtij-atij.

Tek ky shtatë vjeçar i punës së komitetit ka munguar dinjiteti. Nuk e kanë kuptuar komitetin që janë njerëz që vijnë këtu me kualifikime të larta.

Fatime Demolli, pyeti si po e vendosni këtë pikën e dytë të rendit të ditës, të raportit vjetor, a po vendosni me bërë një kërkesë për me monitoruar planin e veprimit dhe pastaj me miratuar asamblistët apo e propozojmë këtë mënyrë vetëm me e ndryshuar.

Premtime Preniqi, tha se ne mundemi me u takuar me nënkryetarin dhe me biseduar, mirëpo me qenë më legjitime që mos me mbet vetëm me neve se çfarë kemi biseduar e çfarë është bërë por p.sh. me e pas të kapshme edhe me dokument me ardhur. Unë e kisha bërë secilës pjesë të planit si në formë pyetësori dhe ju kisha dërguar të gjitha drejtorive të cilat kanë me e plotësuar dhe në bazë të asaj se çka kanë plotësuar dhe ndërtuar.

Fatime Demolli, tha se mendoj me biseduar me kryetarin, nënkryetarin, kryetari me lëshuar një vendim, kush prej anëtarëve po marrin pjesë për me e monitoruar Planin e veprimit.

Në kuadër të atij vendimi secili prej anëtarëve të komitetit me pas një shumë simbolike që paguhet për atë pjesë. Në momentin kur ne e kemi një vendim prej nënkryetarit, unë po besoj që secili prej anëtarëve me atë vendim brenda 3 jave ka me dal në terren dhe me kryer monitorimin për drejtorinë e vetë përkatëse, se si i ndajmë edhe nëse drejtorja, nuk është të paktën zyrtari u jep një përgjigje për ato pikat që ju keni shkruar dhe në këtë mënyrë takohemi prapë, raporton secili, dhe e bëjmë një përmbledhje, ky shkon në Kuvend për miratim.

Gyltene Retkoceri, tha se edhe unë mendoj që është në rregull mendimi juaj vetëm ndoshta është mirë me ia shtuar që kur të shkojnë tek kryetari me i thënë që të paktën një email me ua dërguar apo me mbajt një takim.

Fatime Demolli, tha se nuk ka nevojë email, në momentin kur e lëshon kryetari vendimin, ju me atë vendim shkoni dhe takoheni me drejtoreshën e Arsimit dhe të Shëndetësisë etj.

Premtime Preniqi, sugjeroi me i shkruar Alban Zogajt, më bëni CC, edhe mua dhe shkruani që ne si komitet në mbledhjen e mbajtur kemi dakorduar që ne na duhet të fillojmë me një monitorim të planit të veprimit të PAK-ra, për vitin 2022 dhe dëshirojmë një takim me ju të konsultohemi për hapat e më tutjeshëm.

Jeton Canhasi, tha se e kuptova që po duhet këta që monitorojnë planin me u shpërblyer, por prej që kemi ne anëtarë të komitetit kjo që po paguhet nuk ka ndryshuar fare.

Unë kam pritur që Komuna në ato 500 euro, ka me i përfshirë edhe komitetet sepse ne po punojmë për Komunën.

Fatime Demolli, tha se me sa e di unë Komuna u ka dhënë të gjithë punëtorëve të cilët janë me vendim me kontrata të punës, jo komiteteve, se sikur të u kishte dhënë edhe komiteteve sigurisht do na kish dhënë edhe neve.

Ne me qenë se jemi komitet specifik unë kamë kërkuar prej personit që kam biseduar që vitin tjetër kur të merret vendimi në nëntor, atëherë në tetor me përcjell se kush e bënë këtë vendim, nëse e bënë kryetari atëherë t'i lutemi kryetarit t'i përfshijë edhe shtatë persona të tjerë të komitetit të aftësisë së kufizuar, e para.

E dyta, sa i përket rritjes së mëditjes nëse nuk e bënë Komuna e Prishtinës atëherë kërkojmë prej organizatave të tjera të na mbështesin në monitorimin e Planit të veprimit në teren, e lidhim secili një kontratë, secili jemi përgjegjës për detyrat tona, duhet më i kryer secili drejtoritë e veta, në këtë mënyrë e lidhim një kontratë më cilën do OJQ ose me Kryetarin e Komunës.

Për implementimin e Planit të veprimit, për monitorimin para një kohe na ka paguar "Hendikosi"

e kemi lidhur kontratën me ta dhe secili i ka ndarë detyrat dhe pagesën na e ka bërë "Hendikosi". Në këtë rast ose të na bënë Komuna pagesën me një vendim ose shikojmë organizatat e tjera, dalim e monitorojmë kur jemi të stimuluar, unë mendoj që secili prej nesh i kryen tri apo katër drejtori për një javë ditë.

Premtime Preniqi, tha se mënyrën e monitorimit veç se e paskeni të njohur.

Ramadan Salihu, tha se ky që është tash është raport i punës jo raport monitorues, unë atë raportim monitorues e kam bërë në vitin 2019 për vitin 2018 d.m.th. për vitin paraprak, dhe me të dhëna të sakta p.sh. sa janë respektuar semaforët, sa pjerrinat, sa punësimi etj. Sa i përket planit të monitorimit për mendimin tim unë sugjeroj që mekanizmat me u specifikuar.

Premtime Preniqi, tha se monitorimin duhet tash sa më shpejtë me filluar për shkak se është fjala për 2022 e ne kemi hyrë në vitin 2023, edhe jemi me vonesë.

Ramadan Salihu, tha se deri në fund të marsit të gjithë i dërgojmë raportet nga 31 marsi, ne jemi nxituar e kemi bërë me 19 janar, por kjo nuk prish punë, vetëm që cilësia mundet të rritet me kontributin e juaj të gjithëve.

Premtime Preniqi, tha se mirë do të kishte qenë raporti të bëhet drejtpërdrejtë pastaj monitorimi.

Ramadan Salihu, tha se me monitorim ose duhet në kooperim me një OJQ, apo siç po thotë kryesuesja me vendim të Komunës sepse ne nuk kemi xhirollogari, Kuvendi Komunal nuk ka linjë buxhetore për këtë punë që do të kishte kushtuar përafërsisht rreth 2000 euro, për 5 ose 6 anëtarë, atëherë duhet me një vendim të posaçëm që ne tani me pas mundësi me u lidhë me dikë, OSBE apo KDI, apo kush është ajo që e ka sponsorizuar "Hendikosin", e mandej me ato para me vazhduar me monitoruar.

Fatime Demolli, tha se vetëm le ta miratojë nënkryetari dhe le ta lëshojë vendim dhe të tregojë se cila drejtori mundet ta paguaj këtë pjesë, sepse këtë pjesë mundet me e paguar direkt Kuvendi Komunal.

Premtime Preniqi, tha se sa i përket monitorimit mundemi me biseduar me nënkryetarin, merreni si pikë që edhe raportimin edhe monitorimin dhe në kuadër të asaj ditë i tregoni që prej raportimeve çfarë kanë dal përfundimet e rekomandimeve.

Fatime Demolli, tha se tek raporti vjetor po mbetet të takohemi me nënkryetarin Alban Zogaj, kur të bisedojmë për raportin vjetorë që e kemi pikën e dytë, njëjtë na mbetet pas këtij vendimi me kryetarin edhe monitorimi i planit të veprimit. Nëse nuk kemi zgjidhje nga Komuna kërkojmë nga Premtimja me na dhënë kontaktet e stafit të OSBE-së, iu dërgojmë email si komitet zyrtarisht kështu që i kërkojmë OSBE-së, i pyesim anëtarët se kush dëshiron të jetë pjesë e monitorimit të planit të veprimit, i dërgojmë emrat në OSBE, e shohim se çfarë munden ata me na ofruar dhe e lidhim një kontratë me ta.

Ramadan Salihu, tha se duhet dikush të bëjë buxhetimin e atij projekti që po thoni, anën tekstuale dhe munden ta bëjnë anëtarët e komisionit mirëpo buxheti është pjesë e përvojës, OSBE dhe çdo donator dëshiron të dijë ku po shkojnë parat e tyre, do të thotë sa kushton ajo.

Premtime Preniqi, nëse na financon ndonjë organizatë me të vërtetë është edhe çështja mediatike sepse mundemi pasi të bëhet monitorimi komplet me thirrur një takim me mediat që të bëhet prezantimi i të gjeturave.

Të ndryshme

Jeton Canhasi, shprehi shqetësimin që po maltretohen PAK-ra, duke përfshirë edhe vajzën e tij me aftësi të kufizuara ku tani është certifikimi rreth pensioneve ku PAK-ra, duhet me shkuar në "Hendikos" ata të "Hendikosit", i udhëzojnë me shkuar me i marrë tri mendime të mjekëve dhe prapë me u kthyer në "Hendikos", sepse në "Hendikos" ka me u formuar komisioni. Nuk e di sa kemi ne mundësi por është momenti, secili dihet, edhe mjeku kur e jep diagnozën Friedreich Ataxia ajo është sa të ketë jetë nuk ka shërim e pse mu maltretuar PAK-ra.

Fatime Demolli, tha se çfarë është më e keqja, janë duke ua refuzuar shumicës së personave të drejtën e pensionit.

Jeton Canhasi, a është interesi i mjekëve aty nuk po e kuptoj.

Ramadan Salihu, tha se jam PAK-ra, praktika tregon që si të është i kategorisë së parë më ai nuk ka nevojë për rivlerësim, i kategorisë së dytë e të tretë po, mirëpo kategorisë së parë jo. Çështja është se shoqatave u konvenon sepse marrin mëditje me shkuar në atë komision, aty bëhen çdo ditë apo çdo javë komisione, edhe "Hendikosi", që u ka thënë mi dërguar aty edhe ata marrin para për atë zyre që e lëshon aty.

Jeton Canhasi, tha se kjo është katastrofë, a mundemi me ndikuar ne.

Fatime Demolli, tha se nuk mundemi z. Jeton sepse ajo është çështje e nivelit qendror. Çfarë mundemi të bëjmë ne është me ndikuar në nivel lokal që Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përveç pensioneve i jep diku 150 euro, në vit për atë person, kështu që ju për vajzën e juaj mundeni të aplikoni këtu në Drejtori të Shëndetësisë.

Jeton Canhasi, tha se nuk ka nevojë ai, por po paraqes shqetësimin e të tjerëve.

Gyltene Retkoceri, tha se çështja është që ajo është e drejtë e vajzës tuaj, ato janë para të vajzës tuaj në një formë, përderisa i jep Drejtoria e Shëndetësisë, pse mos me aplikuar me i marrë.

Fatime Demolli, tha se kjo çështje që po e potenconi është në nivel qendror, ka kohë që e ka paraqitur shoqata e "Hendikosit", shqetësimin që shumë anëtarëve nuk po u japin farë pensione, po ua mohojnë të drejtën çka është më e keqja me dokumente me të gjitha dhe nuk po ua japin pensionin.

Ramadan Salihu, tha se do të bëjë një shkresë sepse ajo është shkelje e të drejtave të njeriut, kompetenca nuk kemi por të reagojmë mundemi.

Premtime Preniqi, sugjeroi që këtë shkresë me dërguar në Ministri dhe tek Avokati i Popullit, kjo në një farë mënyre është shkelje e të drejtave të njeriut, diskriminim e të gjitha hyn aty.

Jeton Canhasi, preferoj që me cekë aty që kjo po ndodhë për shkak të interesave personale.

Mbledhja përfundoi në ora 14:45.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli

